



ll 11  
Dher

UNIVERSITETI I SHKODRËS  
“Luigj Gurakuqi”

REKTORI

Nr. prot. 3240

Datë 22.10.2016

UDHËZIM

Nr. 932 Datë 22.10.2016

“PËR

PUNËSIMIN DHE PËRGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË”

Bazuar në ligjin Nr. 80, datë 22. 07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionit e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” noni 57 pika 2, 64, 126 pika 5, statutit të Universitetit noni 38 dhe negullores së zëries dbe ruajtjes së vendit të punës

Udhëzoj

I

Parime të përgjithshme

1. Punësimi i personelit akademik me kohë të plotë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” bëhet me konkurs.
2. Konkursi për vendet e lira shpallet nga Rektori me kërkesë të drejtuesit të njësisë kryesore, buzuar në propozimin e njësisë bazë përkalës.
3. Njoftimi publik për vendin e lirë të punës botohet në Buletinin e Administratës Publike dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të USH jo më vonë se 20 ditë para zhvillimit të konkursit.
4. Njoftimi përmban pozicionin, përshkrimin e vendit të punës, kriteret e përgjithshme dbe të veçanta, afatin brenda të cilit do të kryhen aplikimet, vendin e dorëzimit të dokumentacionit dhe vendin e konkurrimit.
5. Për procedurën e konkurrimit paguhet tarifa e përcaktuar me vendim të senatit dbe bordit të administrimit.

II

Aplikimi

6. Procesi i punësimit të personelit akademik me kohë të plotë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” realizohet përmes aplikimit on-line në faqen zyrtare të USH pas shpaljes së vendit të lirë nga departamentet.

632  
22.10.2016

- Aplikimi duhet bërë brenda afateve të përcaktuara në shpalljen e vendosur në faqen zyrtare të USH për njoftimin e vendit të lirë të punës.
- Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në degën e burimeve njerëzore brenda afatit të përcaktuara në njoftim.
- Aplikanti i cili nuk ka aplikuar on-line dhe nuk ka dorëzuar dosjen me dokumentacionin e kërkuar brenda afateve të përcaktuara në njoftimin zyrtar nuk mund të konkurojë për vendin e shpallur të punës.

### III

#### Përgjedhja e kandidatëve

- Përgjedhja e kandidatëve bëhet nga njësia bazë/departamenti përkatës dhe miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekani i fakultetit përkatës.
- Për përgjedhjen dhe vlerësimin e kandidatëve departamenti përkatës krijon komision *Ad-hoc* me 3 deri në 5 anëtarë. Në komisionin e vlerësimit për personolin akademik caktohen anëtarët e departamentit me titullin dhe gradën më të lartë shkencore. Anëtarët e komisionit më së paku duhet të kenë gradën shkencore "Doktor".
- Komisioni propozohet nga drejtori i njësisë bazë/departamentit dhe miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekani i fakultetit. Kryetari i komisionit është drejtori i departamentit.
- Anëtarët të tjerë komisionit *Ad-hoc* janë përfaqësuesi i caktuar nga dekani i fakultetit dhe përfaqësuesi i caktuar nga rektori i USH.
- Kryetari i komisionit tëdhëq dosjet e aplikantëve nga dega e burimeve njerëzore të USH me procesverbal dhe cakton datën e mbledhjes së komisionit jo më vonë se 5 ditë pas mbylljes së afatit të aplikimit.

### IV

#### Procedurat e përzgjedhjes

- Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve është e përcaktimit të kandidatëve fitues zhvillohet në dy fazë: faza e parë kualifikimi i kandidatëve me dokumentacion, faza e dytë testimi me shkrim dhe intervista.
- Në fazën e parë komisioni shqyron dokumentacionin dhe vendos kualifikimin përfazën tjeter të kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në "Rregulloren e zënisë dhe ruajtjes së vendit të punës" në USH dhe kriteret shpallura për konkurrin. Në këtë fazë, komisioni s'kualifikon kandidatët që kanë mangësi në dokumentacionin e kërkuar, që nuk plotësojnë kriteret e shpallura për konkurrin dhe kandidatët që kanë bërë deklarime jo të vërteta në aplikimin on-line.
- Komisioni *Ad-hoc* përcakton formulën për llogaritjen e pikëve për kandidatët bazuar në "Rregulloren e zënisë dhe ruajtjes së vendit të punës" të USH dhë në kriteret e vendosura nga departamenti dhe bën vlerësimin me pikë të çdo kandidati në bazë të dokumentacionit të dorëzuar.
- Kandidatët e kualifikuar përfazën e dytë njoftohen me email nga kryetari i komisionit *Ad-hoc*. Kopja e emailit të dërguar ruhet në dosjen e konkurrimit dhe bëhet pjesë e

dokumentacionit të konkursit për vendim e shpallur vakant. Një kopje e emaillit vendoset në dosjen e aplikantit dhe bëhet pjesë e dosjes së tij.

## V

### Zhvillimi i konkurrimit dhe shpallja e fituesve

19. Kandidatët e kualifikuar për fazën e dytë të përzgjedhjes i nënshtronhen konkurrimit me testim dhe me intervistë. Datat e zhvillimit të testimit dhe të intervistës përcaktohen nga komisioni *Ad hoc* dhe miratohen nga dekanë i fakultetit dhe shpalen në faqen zyrtare të USH.
20. Komisioni përfshin në pikëzimin e kandidatëve rezultatet që ata sigurojnë në të tre elementet e konkurrimit dhe bëjnë renditjen e kandidatëve në rend zbritës. Renditet i pari kandidati që ka gnumbuluar pikë më shumë.
21. Intervista vlerësohet deri në dyjetë pikë. Çdo anëtar komisioni vlerëson intervistën deri në 10 pikë. Vlera e pikëve të intervistës llogaritet si mesatare e vlerësimit të çdo anëtarit të komisionit.
22. Kandidatët e shpallur fitues me vendim të komisionit njofohen me email nga kryetari i komisionit.
23. Lista e kandidatëve fitues shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ditën e shpalljes së vendimit nga komisioni. Përgjegjës për shpaljen e listës së fituese është kryetari i komisionit *Ad hoc*.
24. Pas përfundimit të konkurrimit dekari dorëzon dosjet e konkurrenteve në degën e burimeve njerëzore dhe dërgon vendimin e komisionit të miratuar nga ai tek rektori.

## VI

### E drejtë e ankimit

25. Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankim tek rektori i USH për vendimin e komisionit brenda posë ditëve punë nga shpallja e tij. Ankim paraqitet në Degën e Burimeve Njerëzore.
26. Rektori shqyrton ankinin dhe i komunikon vendimin kandidatit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.
27. Në përfundim të fazës së ankimit rektori merr vendim për emërimin personal akademik me kohë të plotë të kandidatit të shpalur fitues dhe urdhëron degën e burimeve njerëzore për lidhjen e kontratës me kandidatin e shpallur fitues.
28. Kontrata lidhet nga rektori me afat të caktuar një vit akademik, me të drejtë rinovimi ose jo.



REKTORI  
Dr. ADËM BEKTESHI